



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2023

**PËR**

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIMENË LIGJIN NR.10129, DATË 11.5.2009, “PËR  
GJENDJEN CIVILE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2 “Përkufizime”, pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. “Vendbanimi” dhe “Vendqëndrimi”, si përbërës të gjendjes civile kanë të njëjtin kuptim sipas përkufizimit në Kodin Civil.”

**Neni 2**

Neni 4 ndryshon si më poshtë:

“Neni 4

**Vlera juridike e të dhënave**

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme nëse lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile ose elektronikisht, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Për çdo dokument fizik që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon në mënyrë të plotë, emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.
3. Çdo dokument elektronik, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuara me ligj, përmban nënshkrimin elektronik të nëpunësit që e lëshon. Dokumentet elektronike të

lëshuar nga portali unik qeveritar *e-Albania* përmbajnë vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.”

### **Neni 3**

Neni 13 emërtohet me titullin:  
“Statusi i gjendjes civile”.

### **Neni 4**

Neni 14 ndryshon si më poshtë:

#### **“Neni 14 Deklarimi i vendbanimit**

1. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese që kanë në pronësi brenda ose jashtë vendit brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duke zgjedhur ndër to vendbanimin e tij.
2. Shërbimi i gjendjes civile ofrohet për shtetasit pasi të respektojnë detyrimin e mësipërm.”

### **Neni 5**

Neni 15 ndryshon si më poshtë:

#### **“Neni 15 Regjistrimi dhe ndryshimi i vendbanimit**

1. Regjistrimi fillestar i vendbanimit sipas nenit 14 të këtij ligji, bëhet në zyrën e gjendjes të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial banesën e deklaruar si vendbanim. Shtetasit nuk mund të deklarojnë më shumë se një vendbanim njëherazi.
2. Ndryshimi i vendbanimit, bëhet në zyrën e gjendjes civile të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial vendbanimin e ri, jo më vonë se 30 ditë nga ardhja në këtë vendbanim. I njëjti afat zbatohet edhe për deklarimin e vendqëndrimit.
3. Një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një familjeje tjetër, vetëm kur plotësohen standardet e sipërfaqes së banimit për frymë.
4. Zyra e gjendjes civile regjistron deklarimin e vendbanimit ose ndryshimin e tij kur ai paraqet dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose një kontratë apo çdo dokument tjetër të ligjshëm të parashikuar nga legjislacioni në fuqi që i jep atij të drejtën e përdorimit të banesës.
5. Strukturat komunitare të njësisë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet vendbanimi i ri, kryejnë verifikimet përkatëse, në lidhje me plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë dhe vërtetësinë e deklarimeve. Në rast mosplotësimi të standardeve të lartpërmendura ose deklarimi të rremë, strukturat njoftojnë zyrën e gjendjes civile e cila refuzon kërkesën me arsyetimin përkatës.
6. Ngarkohet ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile të nxjerrë udhëzime lidhur me mënyrën e aplikimit, rregullat për ndryshimin e vendbanimit dhe mënyrën e administrimit të dokumentacionit.”

### **Neni 6**

Pika 2, e nenit 16, ndryshon si më poshtë vijon:

“2. Çdo person madhor, që vendos të jetojë në një vendbanim të ndryshëm nga ai i pjesëtarëve të tjerë të familjes, bën deklaram individual të vendbanimit të tij të ri vetëm pasi të ketë bërë veçim familje.”

#### **Neni 7**

Neni 17 shfuqizohet.

#### **Neni 8**

Neni 18 shfuqizohet.

#### **Neni 9**

Neni 19 shfuqizohet.

#### **Neni 10**

Neni 20 shfuqizohet.

#### **Neni 11**

Neni 21 ndryshon si më poshtë:

#### **“Neni 21**

**Regjistrimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi**

Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi bëhet sipas legjislacionit në fuqi për të huajt.”

#### **Neni 12**

Neni 21/1 shfuqizohet.

#### **Neni 13**

Neni 22 shfuqizohet.

#### **Neni 14**

Neni 25 ndryshon si më poshtë:

#### **Neni 25**

**Llojet dhe veçoritë e përgjithshme të dokumenteve**

1. Përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, të shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim, vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, vërtetohen e dokumentohen në dokumentet bazë të gjendjes civile. Këto dokumente hartohen nga shërbimi i gjendjes civile, në bazë të veprimeve të kryera nga nëpunësit e këtij shërbimi ose dokumentet bazë, të ardhura nga të tretë, në formë fizike ose elektronike, sipas parashikimeve ligjore.

2. Dokumentet bazë, që harton, mban dhe administron shërbimi i gjendjes civile janë:

- a. akti i lindjes;
- b. akti i martesës;

- c. akti i vdekjes;
  - ç. vendimet e komisionit kombëtar për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit;
  - d. vendimet për korigjim si gabim material të drejtorit të përgjithshëm;
  - dh. procesverbalet për bashkim dhe veçim familjar;
  - e. regjistrat themeltarë;
  - ë. Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile;
3. Dokumentet bazë që harton dhe lëshon shërbimi i gjendjes civile janë:
- a. certifikata nga dokumentet bazë që harton, mban dhe administron shërbimi i gjendjes civile për përdorim brenda dhe nga autoritetet e huaja;
  - b. përgjigje ndaj kërkesave të të interesuarve;
4. Llojet, forma, elementet përbërëse si dhe mënyra e hartimit, mbajtjes, administrimit dhe lëshimit të dokumenteve bazë përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”

### **Neni 15**

Në pikën 1, të nenit 33 “Regjistri Kombëtar”, togfjalëshi “dokumenti unik shtetëror”, zëvendësohet me togfjalëshin “baza e të dhënave shtetërore”.

### **Neni 16**

Neni 35 “Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar”, ndryshon si vijon:

“Neni 35  
Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar

Përbërësit e gjendjes civile pasqyrohen në faqen individuale të Regjistrit Kombëtar për shtetasit shqiptarë, shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi me qëndrim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.”

### **Neni 17**

Pas pikës 3, të nenit 38, shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Kur në kohën e regjistrimit të lindjes fëmija nuk është i gjallë, nëpunësi i gjendjes civile regjistron lindjen, sipas rasteve:

- a. Në rast se fëmija ka lindur e gjallë, fëmija regjistrohet me emër në aktin e lindjes dhe më pas mbahet akti i vdekjes.
- b. Në rast se fëmija ka lindur i vdekur, hartohet akti i lindjes pa emër dhe më pas mbahet akti i vdekjes.

5. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e procedurës së regjistrimit të fëmijëve që lindin të vdekur, nga nëpunësi i gjendjes civile.”

### **Neni 18**

Në fund të pikës 2, të nenit 46 shtohet togfjalëshi: “sipas rregullave të miratuara me udhëzim nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile”.

## **Neni 19**

Pas pikës 2, të nenit 57, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Ngarkohet ministri që mbulon gjendjen civile në mbështetje të Kodit të Familjes, të nenit 46 të këtij ligji, të nxjerrë rregullat për procedurën e mbajtjes së martesës dhe dokumentacionit që duhet të sigurojë shërbimi i gjendjes civile për lidhjen e martesës dhe ndryshimin e mbiemrit”.

## **Neni 20**

Pas shkronjës “e”, të nenit 57/2 shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) vendimin administrativ lëshuar nga autoritetet e huaja ku shtetasi shqiptar ka vendbanimin apo vendqëndrimin.”

## **Neni 21**

Pas shkronjës “e”, të nenit 67 shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) lëshojnë vërtetim ku konfirmohet fakti që kemi të bëjmë me të njëjtin person, kur vërejnë se nga një transkriptim në tjetrin për shtetasit shqiptarë ka gabime në një ose më shumë përbërës të gjendjes civile”.

## **Neni 22**

Neni 71 ndryshon si më poshtë:

### **Neni 71**

Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

“1. Nëpunësit e shërbimit konsullor që mbulojnë çështjet e shërbimit të gjendjes civile në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore shqiptare kryejnë të njëjta veprime si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Këta nëpunës, përpara fillimit të detyrës trajnohen si nëpunësit e tjerë të gjendjes civile.

3. Administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar për shtetasit shqiptarë me banim të përhershëm jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

4. Rregullat e administrimit dhe përcjelljes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, për të cilët kryhen veprimet nga nëpunësit konsullorë miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.”

## **Neni 23**

Pas nenit 72 “Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile”, shtohet neni 72/1 me këtë përmbajtje:

### **Neni 72/1**

Trajtimi administrativ i ankesave

- “1. Nëpunësi i shërbimit të gjendjes civile është i detyruar të përgjigjet në mënyrë shkresore ose elektronike për çdo kërkesë të personave të interesuar për shërbimet e gjendjes civile.
2. Kundër refuzimit të nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile apo aktit të tij bëhet ankimi administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.
3. Ankimi administrativ paraqitet te Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile brenda 15 ditëve nga marrja e aktit të nëpunësit të gjendjes civile ose mos kthimit të përgjigjes prej tij. Përmbajtja e ankimit dhe shqyrtimi i tij bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
4. Vendimi i nxjerrë në bazë të ankimit administrativ është i detyrueshëm për zbatim nga nëpunësi përkatës i shërbimit të gjendjes civile kompetent për kryerjen e veprimit administrativ.
5. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile bëhet ankimi në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

#### **Neni 24**

Në nenin 74 “Kundërvajtjet administrative”, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, hiqen togfjalëshat “...në nenin 19 pikat 1 dhe 2, në nenin 20, pika 1....” dhe “...në nenin 18, pikat 2 dhe 3, në nenin 20, pika 2...”.

#### **Neni 25**

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Ministri i Brendshëm që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara në pikën 6, të nenit 5, në pikën 5, të nenit 17, në nenin 18 dhe 19 të këtij ligji”.
5. “Ngarkohet Ministri i Brendshëm dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të nxjerrin udhëzimin në zbatim të pikës 4, të nenit 71 të këtij ligji”.

#### **Neni 26**

##### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYETARI**

**Lindita Nikolla**